



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria Për Shëndetësi
dhe Mirëqenie Sociale

06 Nr __/2023

| | |
|----------|---|
| PËR/TO: | z.Bashkim Ramosaj-Kryetar i Komunës së Deçanit |
| NGA/FROM | Agnesa Vokshi-Drejtoreshë për Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale |

DEÇANI DEÇANI DEÇANI
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT OPSTINA DEÇAN DEÇAN MUNICIPALITY

Nr. 02
Ditë 22.01.2023
Në 2023

Drej. Shëndetësisë 2775

DEÇANI DEÇANI DEÇANI

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

SHËNDETESIA DHE MIRËQENIA SOCIALE JANË DY ASPEKTE TE RËNDESISHME ,TË PËRBASHKETA,QË NDIKOJNË NË CILËSINË E JETËS SË NJË INDIVIDIT DHE KOMUNITETIT NË PËRGJITHËSI.

KOMBINIMI I NJË SHËNDETI TË MIRË DHE MIRËQENIE SOCIALE , KRIJON NJË QËNDRUESHMERI DHE HARMONI NE JETËN E QYTETARIT.

PËRMBLEDHJE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ofron shërbime të qasëshme cilësore, të barabartë për të gjithë qytetarët e komunës, pa dallim feje, race, etnie, gjine.

DSHMS ka zhvilluar aktivitete në të gjitha fushat e veprimtarisë me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithëshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës, përfshirë ktu mbeshtetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe me gjërë.

Fushë veprimtaria e DSHMS-së është bazuar në aktet normative në fuqi dhe planin e punës për vitin 2023,ky raport përfshin në mënyre gjithëpërfshirëse shërbimet e ofruara ne fushën e kujdesit parësor shëndetësor dhe vështiresitë e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

Drejtoria e Shëndetësisë për këtë vit, ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve dhe punësh të cilat i ka pasur të planifikuara me planin e punës 2023.

Fillimisht, në fillim të vitit 2023, DSHMS ka filluar dhe perfunduar hartimin e planit të punës për vitin 2023.

Në këtë plan janë paraparë të gjitha aktivitetet që duhet ndermarrë gjatë vitit 2023,për realizimin e projekteve të ndryshme kapitale si dhe projekteve tjera, gjithashtu shërbimet shëndetësore të cilat do të ofrohen në QKMF, shërbimet për përkuqdesje sociale që ofrohen në QPS (Qendrën për punë sociale) dhe shërbime që ofrohen në SHK (Shtëpinë e Komunitetit)

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë vitit 2023 ka monitoruar me kujdes të gjitha departamentet e saj si:

- QKMF
- QMF
- AMF
- QPS dhe
- SHK.

Ka pranuar takime me qytetarë, ka zhvilluar takime edhe me shumë organizata dhe zyra të huaja më të cilat kemi arritur marrëveshje bashkëpunimi dhe përfitimin e donacioneve kryesisht të natyrës medicinale.

Bashkëpunim më të ngushtë kemi pasur me:

- AMBASADEN JAPONEZE
- KFORIN ITALIAN
- AQH Accessible Quality Healthcare) SDC project implemented by SWIS TPH.

DSHMS për vitin 2023 ka pranuar 135 lëndë, prej të cilave:

- 125-Miratuar
- 2-Refuzuar
- 8-Pezulluar
- 0-Anuluar

Qëndrat që udhëheqen nga DSHMS-ja:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – (Takimet e rregullta me Drejtorin e QKMF-së, Koordinatorin e Cilësisë, Shefat e Reparteve.)

Qendra për Punë Sociale – (Takimet e rregullta me Drejtorin e QPS-së, shefat e sektoreve dhe zyrtarët e kësaj qendre.)

Shtëpia e Komunitetit- (Takimet e rregullta më Menaxheren e Qëndres, dhe punëtorët e kësaj qendre.)

Takimet në mes Drejtoratit dhe qendrave të saj, kane një rendesi të madhe për një menaxhim me efektiv të shërbimeve sociale dhe shëndetësore.

Disa nga arsyet kryesore për mbajtjen e këtyre takimeve përfshijnë:

1. Koordinimin e Shërbimeve (Sigurimi i shërbimeve në mënyrë të përshtatshme dhe efektive)
2. Përcaktimin e Prioriteteve dhe Strategjive (Diskutimi I prioriteteve te reja dhe hartimi I strategjive të përbashkëta për të adresuar sfidat dhe nevojat e komunitetit)
3. Ndarja e Informacionit(Përcaktimi I një mënyre efektive të ndarjës së inofrmacionit në mes drejtorisë dhe qendrave te saj për trajtimet e të gjitha rasteve)
4. Mbikqyrja e Përformancës (Përmes takimeve , mund të zhvillohet mbikqyrja e përformancës për të lerësuar efektivitetin e shërbimeve dhe për të indentifikuar fushat ku mund të përmirësohen)
5. Trajnimi dhe Zhvillimi i Personelit
6. Planifikimi I Emergjencave
7. Bashkëpunimi dhe Partneriteti

Një ndër problematikat kryesore që drejtohet çdo vit tek Drejtoria për Shëndetësi ,është mungesa e barnave esenciale për qytetarët e Komunës së Deçanit.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ,ka zhvilluar takim me Ministrin e Shëndetësisë z.Arben Vitia, duke diskutuar mbi këtë çështje.

Mungesa e barnave esenciale për Komunën e Deçanit ka qenë një problematikë vitët e fundit gjë që ka ndikuar negativisht në ofrimin e kujdesit shëndetësor, dhe për këtë arsye është diskutuar që të këtë një koordinim të mirëfilltë në nivel lokal dhe atë qendror duke ndikuar në përmirësimin e kësaj çështje që është shumë e rëndësishme për qytetarët e Komunës.

Duke parë nga afër nevojat e qytetarëve Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka vlerësuar se Plani Komunal i Veprimit për Kujdesin Parësor Shëndetësor për Komunën e Deçanit është mjaft i nevojshëm për të ngritur cilësinë e shërbimeve dhe përmirësimin e kapaciteteve në menaxhimin e situatave të ndryshme emergjente shëndetësore dhe duke marr përkrahje edhe nga kryetari i komunës ka filluar hartimi i këtij plani.

Plani Komunal i Veprimit për Kujdesin Parësor Shëndetësor të Komunës së Deçanit është hartuar nga Këshilli Drejtues i emëruar për këtë qëllim nga Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj, me vendim **Nr.12/118 të dt. 24.04.2023** si dhe me mbështetjen e AQH (Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor).

Është dokument i planifikimit afatgjatë (pesë vjeçar) dhe gjithëpërfshirës të Kujdesit Primar Shëndetësor (KPSH) në Komunën e Deçanit bazuar në politikat qendore aktuale si dhe në praktikat e mira në nivel global.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka shprehur gatishmeri për bashkëpunim me organizata të ndryshme me qëllim të përmirësimit dhe zhvillimit të komunitetit.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka nënshkruar Momerandum Mirëkuptimi me Insitutin për Politika Zhvillimore (INDEP).

Qëllimi i këtij Momerandumi është krijimi i një kornize për bashkëpunim për të promovuar mundësitë e punësimit, trajnimit dhe arsimimit për të rinjtë në Deçan.

DSHMS ka nënshkruar marrveshje mirëkuptimi për institucionalizimin e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje dhe mënyren e funksionimit të tij, në komunën e Deçanit.

Momerandum Mirëkuptimi është nënshkruar në mes të Komunës së Deçanit (Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale) dhe Komunës së Pejës (Drejtoria për Mirëqenie Sociale). Qëllimi i këtij Momerandumi është:

“Bashkëpunimi ndërkomunal në shkëmbimin e përvojave dhe aktiviteteve të përbashkëta për përkrahjen e moshës së tretë “

Synimet e Drejtorsië për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përcaktohen nga nevojat specifike të komunitetit dhe vizionet strategjike për të përmirësuar shëndetin dhe jetën e popullatës.

Buxheti për vitin 2023 i planifikuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

DSHMS

| | |
|-----------------------------------|-----------|
| Pagat e planifikuara për personel | 14,253,00 |
| Mallra dhe Shërbime | 10,000,00 |
| Komunali | 0 |
| Totali I te hyrave nga B.K.K | 24,253,00 |

Granti për Shëndetësi

| | |
|---|--------------|
| Pagat e planifikuara per personel | 1,021,038,00 |
| Mallra dhe Shërbime | 343,000,00 |
| Komunali | 46,046,00 |
| Planifikimi per investime kapitale | 85,000,00 |
| | 1,495,084,00 |
| Totali I te hyrave nga B.K.K | |
| Buxheti I planifikuar nga të hyrat vetanake | |
| Kapitale | 20,000,00 |
| Totali I te hyrave | 20,000,00 |
| Totali | 1,515 084,00 |

Shërbimet Sociale

| | |
|-----------------------------------|-----------|
| Pagat e planifikuara për personel | 64,255,69 |
| Mallra Shërbime | 20,000,00 |
| Komunali | 7,000,00 |
| Totali i të hyrave nga B.K.K | 91,255,69 |

Shërbimet Rezidenciale

| | |
|-----------------------------------|------------|
| Pagat e planifikuara për personel | 90,000,00 |
| Mallra Shërbime | 75,000,00 |
| Komunali | 8,000,00 |
| Investime Kapitale | 10,000,00 |
| Totali | 183,000,00 |

INVESTIMET KAPITALE

| EMRI I PROJEKTIT | STATUSI I REALIZIMIT | VËREJTJE |
|------------------------------------|----------------------|----------|
| Rinovimi i QKMF | Realizuar | / |
| Furnizimi me pajisje medicinale | Realizuar | / |
| Rinovimi I QPS | Realizuar | / |
| Pajisja me inventar në QMF,dhe AMF | Realizuar | / |
| Furnizimi me Klima | Realizuar | |

MALLËRA DHE SHËRBIME

| Emri Projektit | STATUSI I REALIZIMIT | VËREJTJE | |
|--|----------------------|----------|--|
| Furnizim me material administrativ për zyre për nevojat e shëndetësisë primare | Realizuar | / | |
| Furnizim më reagenca laboratorike | Realizuar | / | |
| Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna për nevojat e QKMF-së | Realizuar | | |
| Furnizim me material stomatologjik për nevojat e | Realizuar | / | |

| | | | |
|--|------------------|---|--|
| departamentit të stomatologjisë | | | |
| Furnizim me material higjieniko-sanitar për nevojat e shëndetësisë primare | Realizuar | / | |
| Mirëmbajtja e objekteve të shëndetësisë primare | Realizuar | / | |
| Mirëmbajtja e automjeteve | Realizuar | / | |
| Mirëmbajtja e pajisjeve | Realizuar | / | |
| Mirëmbajtja e rrjetit | Realizuar | / | |
| Furnizim me naft | Realizuar | / | |
| Instalimi i kamerave të sigurisë | Realizuar | / | |

Kujdesi Paresor Shëndetësor ne Komunën e Deçanit

Veprimtaria e QKMF-së përfshin ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.

Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Deçanit, t'u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirës dhe efikase, të bazuar në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe, njëherit pikë referuese për specialistët konsultat në nivelet të tjera të kujdesit shëndetësor.

Sipas strategjisë së KPSH dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një **mjek familjar dhe dy infermier/e familjare** ofron shërbime shëndetësore për 2000/2500 banorë sipas shtrirjes territoriale , gjeografike dhe organizimit të QKMF-së.

Objektivi i përgjithshëm në harmoni me Strategjinë Sektoriale Shëndetësore të Minsitrisë së Shëndetësisë të Kosovës, objektiva e përgjithshme e strategjisë të KPSH-së është ruajtja dhe përparimi i shëndetit të popullatës në Komunën e Deçanit.

ÇKA ËSHTË KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR (KPSH) DHE ÇKA OFRON?

KPSH është porta hyrëse në sistemin e kujdesit shëndetësor të Kosovës, e cila shërben si pikë koordinuese për të gjitha shërbimet e tjera shëndetësore, sipas nevojës.

KPSH ofron promovimin dhe edukimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm/diagnostikimin, mjekimin/kujdesin dhe rehabilitimin e të lënduarit, të sëmurit me sëmundje akute dhe kronike, si dhe kujdesin e vazhdueshëm për sëmundje të rënda në fazën terminale (kujdesi paliativ), të ofruara në institucione të KPSH-së dhe në komunitet, gjegjësisht në shtëpi.

KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR NË KOMUNEN E DEÇANIT

Komuna e Deçanit ofron shërbime të kujdesit parësor shëndetësor për **40.019** banorë të komunës. Këto shërbime ofrohen në kuadër të rrjetit të institucione shëndetësore që funksionojnë në qytet dhe viset rurale:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) - është një institucion shëndetësor publik që ofron shërbime shëndetësore dhe implementon Mjekësinë Familjare në Deçan.

Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) - funksionojnë në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe ofrojnë shërbime shëndetësore në vendbanimet që kanë mbi 10.000 banorë.

Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF) - ofrojnë shërbime shëndetësore në vendbanimet nën 10.000 banorë.

Në kujdesin parësor shëndetësor ofrohen shërbimet si në vijim:

- ✓ Vizitat mjekësore dhe shërbime në bazë të nevojave të pacienteve si : Dhënia e terapisë parenterale: Injeksione, infuzione, pastrim, fashim, inhalim
- ✓ Shërbime Diagnostifikuese: Analiza Laboratorike dhe Rentgen
- ✓ Edukimi dhe promovimi shëndetësor : këshillim dhe promovim shëndetësor për pacientët me sëmundje kronike , për shëndetin oral, imunizim/vaksinim, konsulta për planifikim familjar
- ✓ Vizita dhe shërbime për të moshuarit me sëmundje të rënda (kujdes paliativ)
- ✓ Kujdesin e vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo-ngjitëse
- ✓ Kujdes urgjent dhe kirurgji e vogël
- ✓ Vaksinim dhe imunizim
- ✓ Promovim i shëndetit oral dhe trajnimin bazik stomatologjik.
- ✓ Kujdes mjekësor në shtëpi (vizita në shtëpi në ratet urgjente, vizita dhe konsulta shtëpiake për nënat dhe fëmijët deri në tre vjeç)
- ✓ Sigurim të shërbimeve ambulatore dhe ndihmë mjekësore gjatë aktiviteteve sportive dhe kulturore.

Orari në Qëndrat Shëndetësore.

| |
|---|
| Mjekësia familjare prej orës 7:00 deri 20:00 , 7 ditë në javë, si dhe shërbimi urgjent i cili është në kuadër të QKMF-së punon 24 orë. |
| Vizita pranë mjekut familjar nga ora 7:00 deri 22:00 , 7 ditë ne javë |
| Shërbimet diagnostike (rentgen dhe laborator) prej 7:00 deri 20:00 , 6 ditë në javë |
| Shërbimet e vaksinimit prej orës 7:00 deri ne orën 15:00 , 5 ditë në javë |
| Pediatria nga ora 7:00 deri në orën 13:30 ,6 ditë në javë |
| Kujdesi oral (stomatologjia) prej orës 7:00 deri në orën 20:00 , 6 dite në javë |
| Shërbimet terapeutike parenterale (infuzionet , injeksionet) jo emergjente te administruara nga mjekët familjar dhe mjekët specialist qoftë një herë apo dy herë në ditë ofrohen nga ora 7:00 deri ne orën 21:00, Infuzionet dhe injeksionet pas kësaj ore ipen vetëm ato qe i ordinon mjeku i urgjencës tek rastet urgjente |
| Shërbimi i URGJENCËS , vazhdon të punoi 24 orë, 7 ditë në javë, duke ofruar shërbime urgjente për qytetarët e Komunës së Deçanit |

Institucionet Shëndetësore në Komunën e Deçanit.

QMF-të

| Institucioni Shëndetësor | Sipërfaqja e institucionit | Popullata që mbulon | Vendbanimet | Orari |
|---------------------------------|-----------------------------------|----------------------------|---|----------------------|
| QMF-Strelc | 450 m ² | 6636 | <i>Strelc i Epërm dhe Strelc i Poshtëm</i> | 5 dite 7:00-15:00 |
| QMF-Isniq | 646 m ² | 5032 | <i>Isniq, Dubovik, Vranoc I Vogël, Lëbushë</i> | 5 dite 7:00-15:00 |
| QMF-Irznig | 192m ² | 4589 | <i>Irznig, Ratishë, Prokulluk, Glllogjan, Kodrali</i> | 5 ditë 7:00-15:00 |

AMF-të

| Institucioni Shëndetësor | Sipërfaqja | Popullata që mbulon | Vendbanimet | Orari i punës |
|---------------------------------|-------------------|----------------------------|--|----------------------|
| AMF Gramaqel | 178m ² | 3564 | <i>Gramaqel Baballog Shaptej Dubravë</i> | 8:00-15:00 |
| AMF Pobergjë | 176m ² | 2721 | <i>Voksh Pobergjë Lloqan Sllup</i> | 8:00-15:00 |
| AMF Prapaqan | 168m ² | 914 | <i>Prapaqan Papiq</i> | 8:00-15:00 |

SEKTORËT NË QKMF-Deçan

Sëktorët që janë në funksion në kuader të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, dhe që i takojnë kujdesit parësor shëndetësor :

- *Shërbimi Urgjent*
- *Mjekësia Familjare*
- *Vaksinimi*
- *Pediatria*
- *Gjinekologjia*
- *Diagnostika*
- *Stomatologjia*
- *Farmacia*
- *Laboratori*
- *Dermatologjia*

Në vitin 2023 fokusimi ishte:

- Ndjekja e trajnimeve për fitimin e njohurive për përmirësimin e cilësisë dhe aplikimi i këtyre njohurive në praktikë.
- Funkcionalizimi i laboratoreve dhe doktorit të stomatologjisë nëpër QMF
- Furnizimi me material laboratorik, stomatologjik, radiologjik, furnizimi me barna për rastet urgjente dhe pajisje mjekësore.
- Furnizimi me derivate për ngrohje dimërore, furnizimi me derivate për automjete, servisimi i automjeteve.
- Servisimi i pajisjeve mjekësore.
- Furnizimi me inventar dhe perde nëpër QKMF, QMF dhe AMF,

Ndër të tjera është bërë:

- shpërndarja e protokolleve të ndryshme tek mjekët
- shpërndarja e dokumentave informative nga MSH dhe IKSHPK nëpër QKMF
- evidentimi i nevojave për inventar dhe pajisje mjekësore nëpër QKMF, QMF dhe AMF
- evidentimi i vajtje – ardhjes nga punëtorët e QKMF, QMF, AMF
- kontrollimi i stokut të barnave brenda repartit dhe regjistrimi i tyre
- kontrolli e qantave të urgjencës, asgjësimi i barnave me afat të skaduar
- kompletimi i setit higjienik, apartures së nevojshme
- kontrolli e protokoleve dhe plotësimi i tyre në mënyren e duhur gjë që vazhdon të bëhet

AQH

Projekti i Kujdesit Shëndetësor me Cilësi të aksesueshme (AQH)

Projekti AQH është krijuar për të mbështetur zbatimin e agjendës kombëtare të reformës dhe për të plotësuar programet e tjera të mbështetura nga donatorët me fokus në nivelin e Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP) dhe sëmundjet jo ngjitëse (SKK).

AQH synon të stimulojë përdorimin e shërbimeve cilësore të kujdesit parësor shëndetësor nga të gjithë qytetarët e Kosovës, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave dhe përfshirjes së popullatave të cënueshme sociale.

Synimi më i mirë i nevojave të klientëve dhe menaxhimi i përmirësuar i shërbimeve do të rrisë cilësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore parësore nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, gjenerimi i kërkesës për shërbime shëndetësore parësore cilësore, duke përfshirë popullsinë në formësimin e shërbimeve, do të çojë së bashku për rritjen e shfrytëzimit racional të të gjitha shërbimeve shëndetësore dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës.

Njejtë si në vitin 2021 dhe 2022 edhe në vitin 2023 kemi vazhduar bashkëpunimin tonë me AQH.

Është punuar në projekte të ndryshme për menaxhim të cilësise si:

1. **auditet klinike**
2. **rishqyrtimet kolegiale.**

Rezilimin i projektit i “**Keshillimores për sëmundjet kronike jo- ngjitëse dhe projekti i mbikqyrjes mbeshtëtese**”.

Në fokus të veçantë ka qenë punimi në **Planin e Veprimit të SMC** dhe realizimin e këtyre **12 blloqeve**, të cilat duhet të realizohen brenda periudhes 2022-2023.

Projekti për “ **Fletënotimin Komunitar**” që synon të përmirësoj shërbimet shëndetësore përmes nevojave të qytetarëve.

Ky dokument është punuar nga stafi udhëheqës DSHMS, QKMF në bashkëpunim më AQH.


Realizimi i Planit të aktiviteteve për Edukim të Vazhdueshëm Profesional për vitin 2023/

Pjesëmarrje aktive në trajnime të brendshme dhe të jashtme:

- 483 Mjekë të profileve të ndryshme
- 144 Mjekë Familjar ose 29.8% ,
- 172 Mjekë të Përgjithshëm ose 35.5%,
- 112 Konsulent ose 23.2% dhe
- 51 trajnime kanë marrë pjesë doktorës e Stomatologjisë ose 10.5 %

- Janë trajnuar mbi 80% e stafit të me temat të cilat i ka përzgjedhur komisioni profesional.

Struktura organizative e QKMF-së dhe shpërndarja gjeografike



Raporti i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore Janar – Dhjetor 2023

| Nr. Rendor | Departamenti (SHERBIMI) | Vizitat | | | | | | | | | | | | | | | Vizita Shëpiake | | |
|------------|----------------------------|--------------|-----------------------------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|----------|----------|-------|-------|---|--------|--|-------|--------------------------|
| | | Ne ordinancë | | | | | | | | | | | | | | | Sherbimet tjera shëndetësore (infirmieri), | Mjeku | Punëtor et tjere shendet |
| | | Mjeku | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | Gjithsej | Vizitat e para sipas moshës | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Gjithsej | < 1 vjet | 1 - 5 | 6 - 9 | 10 - 14 | 15 - 19 | 20 - 24 | 25 - 34 | 35 - 44 | 45 - 54 | 55 - 64 | 65+ vjet | Panjoher | | | | | | | |
| 1 | Mjekësia Familjare | 0 | 52854 | 621 | 1559 | 2394 | 2914 | 5380 | 4109 | 5310 | 6093 | 6866 | 8407 | 9201 | 0 | 76186 | 0 | 0 | |
| 2 | Pediatria | 0 | 7497 | 1056 | 2347 | 2460 | 1383 | 216 | 31 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3690 | 0 | 0 | |
| 3 | Gjinekologji | 0 | 2931 | 0 | 6 | 11 | 25 | 95 | 261 | 707 | 662 | 594 | 349 | 221 | 0 | 1394 | 0 | 0 | |
| 4 | Vaksinimi + Covid 19 | 0 | 3509 | 806 | 273 | 364 | 346 | 332 | 29 | 76 | 70 | 111 | 300 | 802 | 0 | 7099 | 0 | 0 | |
| 5 | Laboratori (DSM+Rt Pcr) | 0 | 7062 | 220 | 382 | 352 | 338 | 256 | 272 | 503 | 611 | 1224 | 1495 | 1409 | 0 | 171661 | 0 | 0 | |
| 6 | Radiologji - Rtg | 0 | 3331 | 36 | 30 | 54 | 63 | 106 | 146 | 275 | 406 | 514 | 734 | 967 | 0 | 15378 | 0 | 0 | |
| 7 | Emergjenca | 0 | 33097 | 1326 | 1829 | 2666 | 3034 | 3306 | 3627 | 3418 | 3772 | 3751 | 3507 | 2861 | 0 | 87845 | 111 | 111 | |
| 8 | Fiziatri-Vizitat | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 9 | Fiziatri-Terapia | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 10 | Internisti | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 11 | EKG | 0 | 3011 | 0 | 1 | 6 | 41 | 51 | 85 | 214 | 316 | 535 | 755 | 1007 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 12 | Echo Kabineti (Mamografia) | 0 | 2155 | 3 | 17 | 22 | 38 | 60 | 187 | 506 | 491 | 442 | 230 | 159 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 13 | Sherbimi Paliativ | 0 | 1759 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 72 | 281 | 592 | 814 | 0 | 1884 | 292 | 0 | |
| 14 | Pulmologu | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 15 | Oftalmologu | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 16 | Dermatologu | 0 | 1901 | 40 | 71 | 113 | 116 | 147 | 150 | 187 | 203 | 243 | 263 | 368 | 0 | 256 | 0 | 0 | |
| 17 | Epidemiologjia | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 18 | Sherbimi Specialistik | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 19 | Mjekësia e Punës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 20 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 21 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 22 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 23 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 24 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 25 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| | Totali: | 0 | 119107 | 4108 | 6515 | 8442 | 8298 | 9949 | 8897 | 11200 | 12696 | 14561 | 16632 | 17809 | 0 | 365393 | 403 | 111 | |

Raporti Financiar Janar – Dhjetor 2023

KUVENDI KOMUNAL DEÇAN
SHPENZIMET

| Insi QKMF- Deçan | | 2023 | | | | | | | | | | | | kodi 631-73900 |
|------------------|--|-----------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|-----------|------------|------------|------------|----------------|
| Nr | Pershkrimi | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Totali |
| A | paga e regullt | 74,591.99 | 84,613.44 | 82,971.1 | 86,128.99 | 84,769.06 | 86,448.36 | 87,934.34 | 87,904.61 | 88,909.74 | 90,544.53 | 87,028.17 | 94,528.51 | 1,036,372.84 |
| 1 | kujdestant dhe punapagesa e sh cov-19 | 4,701.55 | 7,357.04 | 0.00 | 9,429.00 | 7,679.07 | 6,791.48 | 6,686.74 | 3,220.90 | 4,405.75 | 3,245.49 | 2,574.19 | 4,825.00 | 60,916.21 |
| | Me vendime dyvjeç | 7320.59 | | | | | | | | | | | | 7,625.56 |
| B | Total të ardhurat pd | 86,914.13 | 91,970.48 | 82,971.10 | 95,557.99 | 92,448.13 | 93,239.84 | 94,621.08 | 91,125.51 | 93,315.49 | 93,790.02 | 89,602.36 | 99,353.51 | 1,104,909.64 |
| | Të mirat dhe Shërbimet | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 1 | Shpenzimet e udhëtimit | | | | | | | | | | | | | 0 |
| | Shpenzimet e udhëtimit | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 0 | Tot. Shpenzimet e udhëtimit: | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 2 | Komunaliet | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | Telefoni | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | Telefoni fikse | | 82.96 | 126.59 | | | 155.56 | 211.02 | 92.75 | 0 | 92.27 | | 636.26 | 1,397.41 |
| 2 | Uji | | 298.36 | | 332.31 | | 364 | | 64.51 | 0 | 120.44 | | 548 | 1,727.62 |
| 3 | Rryma elektrike | | 2983.17 | 3,676.74 | | | 4,060.38 | 6276.41 | 966.01 | 0.00 | 1577.59 | | 11584.36 | 31,124.66 |
| 3 | Mbetunat (Plehu) | | 665.4 | 363 | 363 | 363 | 363 | 363 | 363 | 0 | 726 | | 726 | 4,295.40 |
| 3 | Pembarusi privat | | | | | | | | | | | 7500 | | 7,500.00 |
| 3 | Totali i Komunaliev | 0 | -4166.33 | 685.31 | 363 | 4942.94 | 6850.43 | 1486.27 | 0 | 2516.3 | 7500 | 13494.62 | 46045.09 | |
| 4 | Komunikimet-Interneti | | | | | | | | | | | | | 0 |
| | Shpenzime tjera te mobile | | 1716.54 | 566.76 | | | 1711.31 | 593.27 | 608.7 | | 1180.96 | | | 6,377.54 |
| | Totali i komunikim | 0 | 1716.54 | 566.76 | 0 | 0 | 1711.31 | 593.27 | 608.7 | 0 | 1180.96 | 0 | 0 | 6,377.54 |
| 4 | SHËRBIMET | | | | | | | | | | | | | 0.00 |
| 4 | Mirëmbajtja e automjeteve | | 1493 | 190.00 | 440 | | 1218 | | 1732 | | 3241.2 | 1141.2 | 1691 | 11,146.40 |
| 4 | Mirëmbajtja e pajisjeve | | 180 | | 320 | | | 325 | | | 4343.6 | 1337.58 | 990 | 7,496.18 |
| 4 | Mirëmbajtja e rjetit | | | | | | | | | | | | | 0.00 |
| 5 | mimmbajtje rutinore | | | | | | | | | | | | | 0.00 |
| 5 | Mirëmbajtja e ndërt.-(objekteve) | | 886.8 | | | | 1583 | 527 | 564.3 | 237.4 | | 7233.7 | 3201 | 14,233.20 |
| 5 | Sherbime kontraktuse tjera pagu | | 21413.35 | 6229 | 3638.7 | | 2855.8 | 2079.52 | 3373.06 | 1773.06 | 2531.24 | 2701.01 | 4873.62 | 51,468.36 |
| 5 | Shërbime -Ven gjyq | | 27199.05 | | | | | | | | | 5502.55 | | 32,681.60 |
| 5 | Shërbimet e per R T G | | 30 | | | | 30 | 30 | | | 30 | | | 120.00 |
| 5 | sherbime kontra tjera asgjesim | | 1740 | | | | | | | | 995.92 | 133 | 6.6 | 2,875.52 |
| 4 | Shërbime tjera- Sigurim dhe regj. autove | | | | | | 633.9 | | | | 241.89 | 1,143.86 | 3126.98 | 5,146.63 |
| 5 | Total Shërbime. | | 52902.2 | 6419 | 4398.7 | 0 | 6320.7 | 2961.52 | 5669.36 | 2010.46 | 11383.85 | 19192.9 | 13889.2 | 125147.89 |
| 5 | Pajisjet/Qirraja/Blerja | | | | | | | | | | | | | 0.00 |
| 5 | Pajisjet | | | | | | | 1897 | | | | | 3000 | 4,897.00 |
| 5 | kompjuter | | | | | | | | | | | | 2000 | 2,000.00 |
| 5 | Paisje speciale mjeksore | | | | | | | | | | | | 12850 | 12,850.00 |
| 6 | Totali i paisjeve | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1897 | 0 | 0 | 0 | 0 | 17850 | 19747 |
| 6 | Fumizimet | | | | | | | | | | | | | 0.00 |
| 6 | Material për zyre | | 4425.5 | | 5200 | | | 4535 | | | | | 13622 | 27,782.50 |
| 6 | karburant per gjenerator | | 156.34 | 569.37 | 345.52 | | | | 375.14 | | 330.19 | | 109.1 | 1,885.66 |
| 6 | Dizell&Benzin për automjete | | 2243.51 | 5219.4 | 1580.8 | 1759.75 | 2,899.79 | 1,589.06 | 1,415.84 | | 4,286.82 | | 5987.57 | 26,982.54 |
| 6 | Material mjekësor (barna, reagje | | 17102.5 | | 2449.1 | | 8983.3 | 1375 | 1272 | | | | 11766.4 | 42,948.30 |
| 7 | Materjal per mimmbajtje dhe higen | | | | | 1544 | | 697.25 | 2524 | 2000 | | 998.90 | 4948.25 | 12,712.40 |
| 7 | Fumizime ushqim dhe pije | | 1312.75 | 74 | | 78 | 141.44 | | | | 78.06 | 53.56 | 163.72 | 1,901.53 |
| | Fur për dimërim -Pelet ,dru | | | 838 | | | | | | | | | 4875 | 5,713.00 |
| | Fur për dimërim -naft | | | 10285.3 | | 7678.2 | 4478.95 | | | | | | 40000 | 62,442.45 |
| 7 | Totali i Fumizimeve | | 25240.6 | 16986.07 | 9575.42 | 11059.95 | 16503.48 | 8196.31 | 5586.98 | 2078.06 | 4670.57 | 998.9 | 81472.04 | 182368.38 |
| | Dreka zyrtare | | | | | | | | | | | | | 0.00 |
| | Cekeni ju lutem: | | | | | | | | | | | | | 0.00 |
| | Totali Të Tjera - | | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| C | Tot. i mali sher | 79,859.34 | 23,971.83 | 13,974.12 | 11,059.95 | 24,536.49 | 13,648.10 | 11,865.04 | 4,088.52 | 17,235.38 | 20,194.80 | 113,211.24 | 333,640.81 | |
| 1 | Kapitalel- | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 2 | Paisje speciale mjeksore | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 3 | paisje tjera | | | | | | | 35850 | | | | | | 35850 |
| 4 | Pembarusi privat | | | | | | | | | | 25000 | | | 25000 |
| 5 | paisje tjera -nxemja lizniq | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 6 | Totali i Kapitaleve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 35850 | 0 | 85000 | 0 | 0 | 0 | 120850 |
| | Totali i Totaleve | 86,914.13 | 170,113.28 | 106,376.17 | 109,532.11 | 103,508.08 | 116,064.02 | 106,778.91 | 138,231.65 | 97,404.01 | 194,844.44 | 109,794.16 | 194,714.75 | 1,605,445.54 |

Departmenti i Shëndetësisë

Të hyrat për vitin 2022

Institucioni Shëndetësor: _____ QKMF "Adem Ukëhax Komuna: DEÇAN
Data e raportimit: 28.12.2023

| Sr. no. | Përshkrimi i të mbledhurave | Aktualish | Parashikimi për | | | | | | | | | | | | |
|---------|-------------------------------------|-----------|-----------------|--------|--------|--------|--------|---------|----------|--------|---------|--------|--------|----------|--------|
| | | | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nandor | Dhjetor | Totali |
| | Pagesat për Participime të ndryshme | | | | | | | | | | | | | | |
| | a.TEHRAT NGË PARTICIPIMI | 487.00 | 458.00 | 439.00 | 321.00 | 318.00 | 354.00 | 317.00 | 1,131.00 | 524.00 | 416.00 | 380.00 | | 5,145.00 | |

| Përshkrimi i të mbledhurave | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nandor | Dhjetor | Totali |
|-----------------------------|--------|--------|--------|--------|--------|---------|--------|----------|---------|--------|--------|---------|--------|
| Te hyrat e planifikuar | 1660 | 1060 | 1660 | 1660 | 1660 | 1660 | 2000 | 2000 | 1660 | 1660 | 1660 | 1660 | 20000 |
| te hyrat e realizuara | 487.00 | 458.00 | 439.00 | 321.00 | 318.00 | 354.00 | 317.00 | 1,131.00 | 524.00 | 416.00 | 380.00 | | 5145 |
| Diferenc | 1173 | 602 | 1221 | 1339 | 1342 | 1306 | 1683 | 869 | 1136 | 1244 | 1280 | 1660 | 14855 |
| shuma e realizuare ne % | 29.34% | 43.21% | 26.45% | 19.34% | 19.16% | 21.33% | 15.85% | 56.55% | 31.57% | 25.06% | 22.89% | 0.00% | 25.73% |



Vizitat e realizuara Vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç gjatë vitit 2023 do ti paraqesim ne tabelën ne vijim :

| Komuna e Deçanit | | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | Total |
|------------------|---|-------|--------|------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|-------|
| 1 | Numri i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç | 76 | 62 | 58 | 88 | 61 | 89 | 120 | 96 | 102 | 132 | 126 | 127 | 1137 |
| 2 | Numri i vizitave në shtëpi për shtatzëna | 5 | 0 | 6 | 10 | 6 | 7 | 6 | 10 | 15 | 6 | 12 | 5 | 88 |
| 3 | Numri total i vizitave në shtëpi të kryera | 81 | 62 | 64 | 98 | 67 | 96 | 126 | 106 | 117 | 138 | 138 | 132 | 1225 |
| 4 | Nr. i fëmijëve vajza 0-3 vjeç të cilat janë vizituar për herë të parë | 9 | 16 | 10 | 8 | 8 | 27 | 27 | 24 | 35 | 29 | 34 | 40 | 267 |
| 5 | Nr. i fëmijëve djem 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë | 11 | 17 | 9 | 9 | 13 | 23 | 31 | 27 | 23 | 40 | 50 | 30 | 283 |
| 6 | Nr. total i fëmijëve 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë | 20 | 33 | 19 | 17 | 21 | 50 | 58 | 51 | 58 | 69 | 84 | 70 | 550 |
| 7 | Numri i vizitave të dyta për fëmijët 0-3 vjeç | 36 | 19 | 25 | 48 | 26 | 26 | 38 | 33 | 34 | 44 | 33 | 37 | 399 |
| 8 | Numri i vizitave të treta për fëmijët 0-3 vjeç | 8 | 7 | 8 | 16 | 7 | 9 | 13 | 6 | 9 | 11 | 8 | 12 | 114 |
| 9 | Numri i vizitave të katërta për fëmijët 0-3 vjeç | 3 | 0 | 5 | 4 | 3 | 3 | 9 | 4 | 2 | 7 | 2 | 5 | 47 |
| 10 | Numri i vizitave të pesta për fëmijët 0-3 vjeç | 0 | 0 | 2 | 3 | 4 | 1 | 1 | 2 | 0 | 1 | 0 | 3 | 17 |
| 11 | Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas | 3 | 10 | 6 | 5 | 6 | 9 | 13 | 10 | 20 | 11 | 22 | 16 | 131 |
| 12 | Numri i shtatzënave që janë vizituar për herë të parë | 2 | 0 | 2 | 4 | 1 | 4 | 4 | 6 | 2 | 3 | 5 | 1 | 34 |
| 13 | Numri i shtatzënave që kanë pranuar vizitën e dytë | 2 | 0 | 4 | 6 | 5 | 3 | 6 | 4 | 13 | 3 | 7 | 4 | 57 |
| 14 | Numri i fëmijëve 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë | 2 | 1 | 1 | 2 | 2 | 1 | 2 | 2 | 1 | 2 | 2 | 2 | 20 |
| 15 | Numri i grave shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 2 | 1 | 1 | 1 | 2 | 13 |
| 16 | Numri i fëmijëve të referuar tek specialistët mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare | 6 | 4 | 3 | 4 | 8 | 5 | 7 | 8 | 6 | 7 | 6 | 7 | 71 |
| 17 | Numri i vizitave shitesë për fëmijë dhe shtatzëna (Jashtë standardit të programit të vizitave në shtëpi) | 11 | 6 | 2 | 12 | 12 | 20 | 12 | 14 | 10 | 12 | 20 | 2 | 133 |
| 18 | Numri i baballarëve të përfshirë gjatë vizitave në shtëpi | 55 | 42 | 50 | 62 | 21 | 52 | 23 | 30 | 32 | 42 | 45 | 58 | 512 |
| 19 | Numri i rasteve sociale të identifikuara dhe të referuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 20 | Numri i rasteve të dhunës të identifikuara (nga observimi gjatë vizites në shtëpi) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 21 | Numri i fëmijëve të identifikuara me ngecje në zhvillim dhe të referuar (nga observimi gjatë vizites në shtëpi) | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| 22 | Numri i infermierëve që janë angazhuar në zbatimin e vizitave në shtëpi | 6 | 4 | 5 | 6 | 6 | 7 | 6 | 5 | 5 | 5 | 5 | 4 | 7 |

Donacionet:

Gjatë vitit 2023 QKMF së bashku më DSHMS ka pranuar këto donacione:

- Donacion nga AQH- Kompletimi i këshillimores (duke intervenuar në infrastrukturë dhe furnizimi me pajisje dhe dokumentacion mjekësor)
- Donacion nga AQH- Furnizim me makina elektrike për mirëmbajtjen higjienikë- 4 copë, si dhe mjete përcjellëse për pastrim.
- Donacion nga AQH- 4 ekrane televizive me USB me material edukues dhe këshillues për pacient si dhe me materiale (broshura për pacient).
- Donacion nga AQH- Aparati për analizën **Hba1c**
- Donacion nga KFORI Italian- Furnizim me makina elektrike për mirëmbajtjen higjienike 2 copë si dhe një autoklave, një paketues për instrumente dhe një destilator.
- Ambasada japoneze- Ultrazë dhe Autoklav .
- Ministria e shëndetësisë – Automjet për vaksinim dhe vizita nëna dhe fëmijë
- IKSHPK- Frigorifer për vaksinim për QKMF dhe QMF
- European center for minority issues Kosovo – Furnizim me ultrazë portable, paketues për instrumente, qantë emergjente me pajisje përcjellëse.
- IKSHPK- Llaptops Lenovo, 4 copë
- John Goqi- 10 termometra digjital
- Donacion nga AQH- Qantë emergjente , 3 copë për QMF
- Donacion nga GIZ - Pajisje për grumbullimin e mbeturinave.
- Donacion nga UNICEF- 1 Laptop Lenovo dhe 6 Tableta
- ATOMED- 1 Tensiometër dhe një stetoskop

KATEGORITË E LIRUARA NGA BASHKËPAGESA NË INSTITUCIONE SHËNDETËSORE:

- Imunizimi
- Fëmijët parashkollorë
- Nxënësit dhe studentët
- Invalidët e luftës
- Rastet me asistencë sociale
- Sëmundjet kronike
- Shërbimet emergjente
- Personat e moshuar mbi 65 vjeç
- Personat me aftësi të kufizuara
- Familjet e dëshmorëve
- Familjet e viktimave civile
- Invalidët civil
- Të burgosurit politikë

*Për çdo shqetësim tuajin të nderuar qytetar, bisedoni me personelin shëndetësor apo një nga përgjegjësit e institucionit. Përndryshe, mund të leni shënim në kutinë e ankesave që gjendet në institucionin shëndetësor, apo në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ju gjithashtu mund të kontaktoni Ministrinë e Shëndetësisë përmes linjës telefonike falas për ankesat e pacientit, në numrin **0800 17777** ose përmes adresës elektronike: linjafalas@rks-gov.net*

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Qendra për Punë Sociale është institucion publik profesional i nivelit Komunal. QPS-të si organe kryesore të autoriteteve komunale , janë të mandatuara për të ofruar kujdes social, mbrojtje sociale, dhe shërbime sociale për fëmijët dhe familjet në nevojë, si dhe për të koordinuar dhe organizuar një sistem të integruar të shërbimeve sociale dhe familjare brenda secilës komunë

Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligjin për shërbime sociale dhe familjare, komunat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale brenda teritorit të tyre , sipas standardeve dhe politikave të qeverisë apo ministrive përkatëse.

Drejtoritë Komunale përkatëse për Mirëqenie Sociale janë përgjegjëse për çështjet komunale të Mirëqenies Sociale dhe i menaxhojnë edhe QPS-të, të cilat kanë përgjegjësi për të ofruar shërbime sociale dhe familjare për qytetarët me nevojë.

Komunat janë të obliguara të :

- indentifikojnë nevojat për ofrimin e shërbimeve sociale për qytetarët e komunës
- planifikojnë shërbimet
- ofrojnë financim
- menaxhojnë shërbimet sociale brenda komunës

Pritët që me aprovimin e Projekt Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal do të punohet edhe në hartimin e një udhëzimi administrativ, që do të rregullonte funksionimin dhe shpërndarjen e Grantit Specifik për shërbime sociale.

Që nga janari 2023, përgjegjësitë për hartimin e politikave, standardeve, dhe inspektimet e shërbimeve sociale, janë transferuar nga Ministria e Financave , Punës dhe Transfereve, në Ministrinë e Drejtësisë.

Përfituesit e mbrojtjes sociale definoohen si përsona me gjendje nevoje. Në këtë grup bien përsonat të cilët kanë nevojë për shërbime sociale nga këto arsye:

- Fëmijë pa përkujdesje prindërore
- Fëmijë me sjellje asocial
- Dilikuent të mitur
- Marrëdhënie të çrregulluara në familje
- Moshë e shtyer
- Sëmundje trupore ose aftësi të kufizuara fizike
- Aftësi të kufizuara mendore
- Sëmundje mendore
- Rrezik nga shfrytëzimi ose abuzimi
- Dhunë në familje

- Trafikim të qenieve njerëzore
- Varësi nga alkooli ose drogat
- Emërgjenca ose fatkeqësi të shkaktuara nga natyra apo njeriu

STRUKTURA ORGANIZATIVE E QPS-së

Shërbimi social -është shërbim profesional (grup ekspertësh) në kuadër të QPS-së që ofron shërbime sociale dhe familjare dhe kryen funksionin e Organit të Kujdestarisë

Shërbimi i Asistencës Sociale- është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Skemës së Ndihmave Sociale.

Shërbimi Administrativ Financiar -është përgjegjës për administrimin e buxhetit dhe financave të institucionit të QPS-së si dhe punët teknike administrative

Ndër profilet kryesore dhe të nevojshme në shërbim social janë: **Puna sociale dhe Psikologia**. Mungesa e profilizimit dhe ngarkesa enorme e punojësve me lëndë rezulton një gjendje që rrezikon ofrimin e shërbimeve dhe cilësin minimale të shërbimit për përfitues.

Numri I zyrtarëve të shërbimeve sociale në Komunën e Decanit.

| Komuna | Gjithsej popullsia | Nr i zyrtarëve të shërbimeve sociale | Nr I zyrtarëve të asistencës sociale | Sa raste ka mesatarisht një zyrtar në shërbime sociale brenda një muji ose viti |
|--------|--------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|---|
| Decan | 40,019 | 3 | 5 | 6 raste në muaj |

Përbërja dhe profilet e stafit në Organin e Kujdestarisë.

| | | |
|--------|--|-------------------------------------|
| Komuna | Nr I stafit të Organit të Kujdestarisë | Përbërja e Orgranit të Kujdestarisë |
| Decan | 3 | 1 pedagog, 1 sociolog, 1 ekonomist |

Kushtet e Punës, hapsirat e zyrave, automjetet dhe pajisjet teknike.

| | | | | |
|--------|-----------|--------------|---------|----------------|
| Veturë | Kompjuter | Zyre/Hapsirë | Telefon | Printer/Skaner |
| 1 | Posedon | Posedon | Posedon | Posedon |

Shërbimet e ofruara nga muaji JANAR-DHJETOR

| Nr | Llojet e shërbimeve të kryera | Janar - Nëntor | Gjithsejt |
|----|--|----------------|-----------|
| 1 | Të miturit në konfikt me ligjin- Delikuenca | 33 | 33 |
| 2 | Fëmijet e keqtrajtuar | 01 | 01 |
| 3 | Fëmijet e braktisur , potencial për adoptim | 0 | 0 |
| 4 | Fëmijet pa perkujdesje prindërore në strehim te të afermit – me pagesë | 0 | 0 |
| 5 | Fëmijet me aftesi te kufizuara | 08 | 08 |
| 6 | Kujdestaria ndaj femijëve | 03 | 03 |
| 7 | Kërkesat për adoptim | 07 | 07 |
| 8 | Dhuna në familje | 23 | 23 |
| 9 | Viktima të trafikimit | 0 | 0 |
| 10 | Kërkesa për këshilla martesore | 08 | 08 |
| 11 | Familje strehuese | 0 | 0 |
| 12 | Mbrojtja e personave të moshuar –vendosja në Shtepinë e Pleqëve | 01 | 01 |

| | | | |
|----|--|-----|-----|
| 13 | Puna e rrezikshme e të miturve | 02 | 02 |
| 14 | Përdorurit e substancave narkotike | 02 | 02 |
| 15 | Përdorurit e alkoolit | 0 | 0 |
| 16 | Martesa e të miturve | 01 | 01 |
| 17 | Vizita në teren | 70 | 70 |
| 18 | Përfaqsim në seanca gjyqësore | 52 | 52 |
| 19 | Kontaktime të zhvilluara me familje dhe femijë | 123 | 123 |
| 20 | Vërtetimi për aplikim të shlyerjes së shtetësisë së Kosovës | 100 | 100 |
| 21 | Vërtetimi për armë-mbajtje | 407 | 407 |
| 22 | Çertifikata për aplikim- punësim | 43 | 43 |
| 23 | Konstatime , sygjerime , udhëzime të ndryshme | 88 | 88 |
| 24 | Caktimi I kujdestarit pas marrjes së zotësisë së veprimit nga gjykata | 03 | 03 |
| 25 | Përpilimi I raporteve për shërbimin e SAS-it | 24 | 24 |
| 26 | Anamnezë për bashkim familjarë | 13 | 13 |
| 27 | Vërtetimi për mbajtje financiare për anëtarët e familjes nga familjarët në botën e jashtme | 10 | 10 |
| 28 | Autorizime për udhëtime jasht vendit | 0 | 0 |
| 29 | Raporte për shkurorizime | 08 | 08 |
| 30 | Aktvendime për kompletimin e dokumentacionit për femijë kur njeri nga prindërit gjendet në botën e jashtme | 0 | 0 |
| 31 | Vendosja e femijëve të brakisur në SOS fshat- Prishtinë | 0 | 0 |
| 32 | Vendosja e grave me femijë në Shtëpinë e Sigurt pas dhunës në familje | 02 | 02 |
| 33 | Marrja e të drejtës prindërore për femijët e keqtrajtuar nga ana e prindërve | 0 | 0 |
| 34 | Vendosja e grave me femijë tek të afermit pas dhunës në familje | 08 | 08 |
| 35 | Vizita nëpër shkolla | 20 | 20 |
| 36 | Regjistrimi i femijëve që nuk i dihet baba | 0 | 0 |
| 37 | Përkujdesja ndaj familjeve të riatdhesuara | 0 | 0 |
| 38 | Përfaqesim në polici | 45 | 45 |
| 39 | Aktvendime të ndryshme | 17 | 17 |
| 40 | Shënime zyrtare | 01 | 01 |
| 41 | Kërkesa | 08 | 08 |
| 42 | Konstatime | 02 | 02 |
| 43 | Njoftime | 05 | 05 |
| 44 | Raporte për FAKP-në | 05 | 05 |

| | | | |
|----|---------------------|------|------|
| 45 | Pelqime të ndryshme | 17 | |
| 46 | Raporte të ndryshme | 32 | 32 |
| 47 | Gjithësej | 1184 | 1184 |

SHTËPIA E KOMUNITETIT

Shtëpia e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore ka për qëllim të ofroj një mjedis të përshtatshëm dhe mbështetës për këtë grup të veçantë të individëve.

Roli i Shtëpisë së Komunitetit në Deçan është i veçantë dhe i domosdoshëm për rrethanat ekzistuese meqenëse një numer i caktuar i personave kanë nevojë për një përkujdesje të vazhdueshme nga institucionet. Aktualisht në Shtëpinë e Komunitetit në Deçan, janë 9 pacientë, të cilët kanë përkujdesje të vazhdueshme nga stafi mjekësorë dhe stafi percjellës :

- Infermierët
- Neuropsikiatri
- Psikologjia
- Sigurimi

Këtë vit kanë qenë 4 kërkesa për vendosje të rezidentëve , të cilat janë shqyrtuar nga Komisioni i përzgjedhur, sipas UA Nr 11/2014 për punën dhe kriteret për vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore.

Aktivitetet e realizuara në SHK në periudhën Janar – Dhjetor

- Përkujdesja mjekësore
- Pranimi i banorëve të rinjë (që përzgjedhen nga DSHMS në bashkëpunim me Dr.Nysret Pepaj, Neuropsikiatër dhe komisionin e përzgjedhur ,në bazë të shkallë së retardimit)
- Vizitat familjare
- Mirëmbajtja e objektit
- Monitorimi i punës së Shtëpisë së Komunitetit

Shërbimet e ofruara ndaj pacientëve në periudhën Janar- Dhjetor

Përkujdesja nga stafi i SHK ndaj rezidentëve

- Shërbimet laboratorike
- Vaksinat Sezonale
- Kontrolla nga specialistet e ndryshem sa i përkëtë gjëndjes shëndetësore
- Kontrolla nga Neuropsikiatri
- Kontrolla nga Psikologu Klinik
- Sigurimi i barnave të nevojshme

Aktivitetet në SHK të realizuara në periudhën Janar- dhjetor

- Realizimi i projektit për riparimin e nyjeve sanitare.
- Realizimi i projektit për rinovim të SHK.
- Servisimi I automjeteve.
- Furnizimi me naftë.
- Furnizimi me mjete hixhenike.
- Furnizimi me ushqim.
- Monitorimi dhe bashkëpunimi me Ministrinë dhe znj.Ganimete Murseli.
- Ekskurzionet

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

